

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TRACK AGENCY” SHPK

Sot, më datë 26/09/2024, ortakët themelues:

1. **Z.ISAN HYDI** -shtetas shqiptar, i biri i Astritit, lindur në Berat, i datelindjes 19.05.1980, me banim në adresen: Lagjia 30Vjetori, Berat, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal I00519063A.
2. **Z.SAIMIR BERBERI**- shtetas shqiptar, i biri e Arqilese, lindur në Berat, i datelindjes 28.01.1987 me banim në adresen: Rruga: jakov Mile, Fier, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal I70128087R.

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Track Agency ” Shpk me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Track Agency” Shpk themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2. Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “**TRACK AGENCY**” Shpk.

NENI 3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtem:

Shoqëria ka për objekt ushtrimin: Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit, ofrim domain-esh, sherbime web hosting, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si dhe marketing online, mirembajtja.Hartim dhe implementim projektesh ne fushen e teknologjise se informacionit. Zhvillim software, platforma dixhitale, ecommerce dhe shitja e programeve kompjuterike per perdorim ne fusha te ndryshme.Ofrimi i sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit. Sherbime marketing ne fushen e monitorimit te medias elektronike dhe te shkruar, perpunime statistikore. Publikime, dhenie informacioni on-line, media te shkruara, media audio-vizive, sherbime ne fushen e perkthimit etj. Konsulenca ne lidhje me aplikimin e teknologjise se informacionit ne fusha te ndryshme. Shitje produktesh online e offline edhe per llogari te paleve te tjera, ndermjetes ne biznese ,

TRACK AGENCY SHPK
AKT THEMELIMI



shitje offline e online te produkteve dixhitale, shitblerje aksione ne kompani te tjera ose shitblerje te kompanive te tjera. Shoqëria do te kryeje pa kufizim cdo aktivitet tjetër te lejueshem nga legjislacioni ne fuqi edhe pse jo i permendur ne kete akt.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

NENI 4. Selia e Shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresen: Rruga “Artan Lenja”, Vila 3 kateshe, Nr.7, Kati 1. Adresa e selise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej **100,000 (Njeqindmije) Lekë**, i ndare ne **2(dy)** kuota .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Z.ISAN HYDI** Zotërues i 1(një) kuote që përfaqson 50% te kapitalit të shoqërise me vlerë 50,000 (pesedhjetemije) leke.
- **Z.SAIMIR BERBERI** Zotërues i 1(një) kuote që përfaqson 50% te kapitalit të shoqërise me vlerë 50,000 (pesedhjetemije) leke.
-

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

TRACK AGENCY SHPK
AKT THEMELIMI




3. Administrator i pare i shoqërisë do të jetë Znj.Vjola Hydi - shtetase shqiptar, e bija e Kujtimit ,lindur në Berat, i datelindjes 01.03.1996 me banim në adresen: Rruga :Zef Jubani , Tirane mbajtës i leternjoftimit me nr. personal J65301059I, me një mandat 5 (pese) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspërti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12. Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14. Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

TRACK AGENCY SHPK
AKT THEMELIMI




ORTAKËT THEMELUES

1. ISAN HYDI
2. SAIMIR BERBERI

Isan Hydi
Saimir Berberi